

Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik


Plani strategjik 2024-2027 "Për veprimtarinë e SUOGJ-së", ka si qëllim përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të Spitalit identifikimin e sistemeve/fushave me nivel të lartë rrisht, si dhe përcakton punën që do të ndërmerret nga ana Drejtorisë për vitet në vazhdim.

🚩 Objektiva Strategjik 2024-2028

1. Aplikimi dhe zbatimi i autonomisë spitalore
 - Mbështetja e punës së Bordit Drejtues së SUOGJ-së.
 - Zbatimi i gjithë bazës ligjore për aplikimin e autonomisë spitalore.
2. Hartimi i Manualit të Procedurave Standarde Operacionale, në SUOGJ.
 - Hartimi i planit strategjik për përmirësimin e aktiviteti spitalor.
 - Hartimi i Planit për Organizimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore
3. Ofrimi i praktikës së dyfishtë në mbështetje të autonomisë spitalore.
 - Rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët/pacientët.
 - Rinovimi i pajisjeve me teknologji bashkohore.
 - Rinkonstruksioni i ambjenteve të amortizuara ndër vite.
 - Ulja e kohës së pritjes të pacienteve Qendrën e shëndetit të gruas, Repartin e Urgjencë Pranimit, (takim, shtrim, ekzaminimi, operacion etj .)
 - Rritje e kënaqësisë së pacienteve.
 - Monitorimi i zbatimit të rregullave të Sistemit të Referimit dhe ndërgjegjësimi i drejtpërdrejtë i popullatës dhe personelit mjekësor për zbatimin e rregullave të Sistemit të Referimit.
4. Përmirësimi i kostos dhe efikasitetit.
 - Planifikim buxhetor më i saktë, që i përgjigjet nevojave reale;
 - Përmirësimi i planifikimit buxhetor për parashikimin e nevojave për medikamente.
 - Menaxhim më i mirë spitalor përmes teknologjisë së informacionit (sistemeve të informacionit).
5. Të përmirësojë sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe proceset në lidhje me personelin
6. Mbështetja të gjithë punonjësve me trajnime.
 - Organizimi i kulturës institucionale dhe adoptimi i përkatësisë.
 - Rritja e nivelit të kënaqësisë së personelit në anketat e vlerësimit të përgjithshëm.

7. Rritja e sigurisë së pacientit dhe punonjësve
 - Rritja e masave të sigurisë për punën dhe shëndetin.
 - Mbështetja e punës së komisionit të kontrollit të Infeksioneve.
8. Rinovimi i infrastrukturës elektronike të SUOGJ-së.
 - Rinovimi i rrjetit netëork, pajisja e gjithë sistemit spitalor me kamera, pajisja me ëireless, Sistemi i navigimit të brëndshëm, themelimi i arkivit.
 - Implementimi dhe dixhitalizimi i spitalit në kohë reale dhe krijimi i databazave për çdo paciente.
9. Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së parandalueshme.
 - Reduktim i nivelit të vdekshmërisë foshnjore perinatale.
 - Reduktim i nivelit të vdekshmërisë amtare dhe neonatale.
10. Reduktimi i nivelit antibiotikoterapis.
 - Hartimi i politikave të përdorimit të antibiotikëve.
 - Unifikimi i protokolleve dhe udhërrëfyesve mjekësor.
11. Sigurimi i mirëmenaxhimit, integritetit, transparencës dhe aksesit në shërbimet shëndetësore, me mbështetjen e partneritetit llogaridhënies public-privat dhe modeleve të tjera për mobilizimin e burimeve shtesë.

SIMSTEMI I REFERIMIT DHE KOHA E PRITJES

- Koha e pritjes së pacienteve më e shkurtër.
- Numri optimal i vizitave dhe kohë normale në dispozicion të mjekut.
- Rregull dhe rradhë e kontrolluar nëpërmjet sistemit të referimit që siguron qetësi, si dhe ndjekjen e të sëmurave kronike të kartelizuara.
-  Treguesit e performancës në Sallat e Operacionit të SUOGJ.

Treguesit e performancës në sallat e operacionit në obstetrik-gjinekologji përfshijnë një set të specializuar të meritave për të vlerësuar cilësinë, efikasitetin dhe sigurinë e shërbimeve kirurgjikale.

Treguesit e shpërndarjes së kohës: Përfshijnë kohën që pacientët presin për të marrë operacionin, kohën që qëndrojnë në sallë para dhe pas operacionit, dhe kohën që i shkojnë nëpër procedurat pasoperacionale.

Treguesit e sigurisë së pacientit: Përfshijnë numrin e infeksioneve nosokomiale, komplikacionet kirurgjikale si lëndime të organeve të tjera gjatë operacionit, dhe shkallën e keqkuptimeve në trajtim.

Rezultatet e para dhe pas operacionit: Përfshijnë numrin e lindjeve normale në raport me cesarianet, shkallën e lindjeve paraprake të detyruara, dhe cilësinë e kujdesit pas operacionit për të siguruar shërimin e shpejtë dhe të plotë.

Kosto dhe efikasiteti: Përfshijnë koston e procedurave kirurgjikale, duke përfshirë kosto materiale, personelit dhe kohën e përdorur për çdo operacion.

Përdorimi i teknologjisë dhe inovacionit: Përfshijnë përdorimin e teknologjisë së fundit dhe metodave kirurgjikale inovative për të përmirësuar efikasitetin dhe rezultatet për pacientet.

Treguesit e përvojës dhe kualifikimeve të personelit: Përfshijnë përvojën dhe kualifikimet e kirurgëve, mjekëve anesteziologë, infermiereve dhe personelit tjetër të sallës së operacionit. Treguesit e përshtatjes me standardet e praktikës: Përfshijnë nivelin e përputhjes së procedurave kirurgjikale me standardet e praktikës së mirë në fushën e obstetrikës dhe gjinekologjisë.

Këto tregues të performancës janë të rëndësishme për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve kirurgjikale Në SUOGJ “KOÇO GLIOZHENI”.

- Në sallën e operacionit kryhen të gjitha ndërhyrjet e nevojshme
- Steriliteti i sigurt: Rënie thuajse absolute e infeksioneve post- operatore.